

STATUT I SHOQERISE
“IDE INVESTMENT” Sh.P.K.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 25 /03/2019, personat e mëposhtem:

Z. Doni Berberi, shtetas shqiptar, i biri i Aranitit, lindur me 30.05.1972 ne Vlore, banues ne Tirane, mbajtës i kartes se identitetit me nr. 033506604 dhe nr. H20530132D, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar; dhe

Z. Ilir Dena, shtetas gjerman, i biri i Rahimit, lindur me 07.01.1969 ne Gjirokaster banues ne Kurschnerweg 32,33659 Bielefeld Gjermani mbajtës i kartes se identitetit gjermane me nr. 555622483, e vlefshme deri dt. 15.11.2019, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, njohes shume i mire i gjuhes shqipe;

Z. Elton Aliaj, shtetas gjerman, i biri i Ramazanit, lindur me 31.03.1977 ne Tirane banues ne Habichtshof 10,49134 Wallenhorst Gjermani,mbajtës i kartes se identitetit gjermane nr. L2K7VCCCC0, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, njohes shume i mire i gjuhes shqipe;

ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miratuan kete Statut si vijon:

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit


Sot, më 25/03/2019 ne, themeluesit e mesiperm, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emertimin tregtar “IDE INVESTMENT” SH.P.K.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Objekti aktivitetit te Shoqerise eshte kryerja e cdo aktivitet tregtar te lejuar nga legjislacioni Shqiptar, dhe vecanerisht: Zhvillimin e projekteve imobiliare, kryerjen e aktiviteteve te blerjes, shitjes dhe zhvillimit te tregtise dhe/ose cdo lloj transaksioni ne lidhje me pasurine e paluajtshme dhe te luajtshme, ose te drejtave te disponimit ne lidhje me to;


JB

- Negocime, ndermjetesime, perfaqesime te te treteve ne fushen e real estate si ne tregun e brendshem ashtu edhe ate nderkombetar;
- Kryerjen e aktiviteve te pergatitjes, aplikimeve dhe/ose ndertimeve ne zona civile, industrial, turistike dhe bujqesore;
- Rikostruksion dhe mirembajtje , veshje fasadash, rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale;
- Keshillimin dhe menaxhimin e projekteve ne sektorin e energjise dhe minierave, ndertimi i impjanteve per prodhimin e energjise elektrike, nenstacionet, kabinat e transformatoreve, punime nentokesore, ura vepra arti, diga dhe tunele hidroteknike, ujesjellsa, gazsjellsa, vepra kullimi dhe vaditje. Importeksporti produkteve te cdo lloji;
- Aktivitete te tjera qe lidhen me zbatimin e punimeve ne ndertim si dhe veprimtari tregtare te tjera ne pergjigjesi dhe pa kufizim;
- Te kryeje cdo biznes si nje shoqeri e pergjithshme tregtare. Prodhimin, hedhjen ne treg, tregtimin me shumice dhe pakice, importimin, eksportimin e barnave mjekesore, prodhimeve kozmetike, shtesave ushqimore, pajisje mjekesore, materiale mjekimi, produkte galenike. Import - Eksport te lendeve te para, ndihmese, ambalazheve dhe i materialeve, qe perdoren per prodhimin dhe konfeksionimin e barnave;
- Perpunimin, eksportimin, importimin, tregtimin e produkteve farmaceutike gjysem te gatshme;
- Tregtimin, importimin dhe eksportimin e materialeve te konsumit mjekesor dhe pajisjeve mjekesore;
- Zhvillimin e aktiviteve per promocion marketing mjekesor dhe farmaceutik. Sherbime kerkimore dhe zhvillimore ne fushen farmaceutike; kerkime biologjike; kerkim kimike; kerkime mjekesore dhe cdo aktivitet tjetër te lejuar me ligj.
- Pervec kesaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperm. transportin e mallrave dhe te udhetareve me mjetet e shoqerise ose te te treteve, brenda dhe jashte vendit.
- Tregtimin me shumice dhe pakice, import- eksport te mallrave te te gjitha llojeve, si industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, elektroshtepiake, konfeksione, tekstile, kinkalери, cigare, kimikate, prodhime qelqi, porcelani, plastike, lekure, lende te konservuara, pije alkoolike dhe freskuese, lende dhe materiale ndertimi, elektrike, elektronike, pllaka, materiale hidrosanitare, prodhime druri, duralumini, makinerive te te gjitha llojeve dhe pjeseve te kembimit, automjete te te gjitha tonazheve, parfumerise, kancelarise, detergjenteve.;
- Kryerja e çdo veprimtarie tjetër tregtare, që mund të realizohet nga një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjit shqiptar dhe që nuk vjen në papajtueshmëri me veprimtaritë e mësipërme.

Ne funksion te qëllimeve te mësipërme Shoqëria mund te hyje ne tregje dhe operatione te ndryshme, te zotërojë pasuri te luajtshme e te paluajtshme dhe/ose pjesëmarrje ne shoqëri te tjera tregtare.

**Neni 3
Kohëzgjatja**


Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e ***pacaktuar dhe/ose e pakufizuar***.

Neni 4

E. A.



J. D.



Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Shqipëri, Tiranë, Njësia Bashkiake nr2 Rr. Ali Demi, Pall. 74, shk. 5, Ap. 10, kati 4.**

Me vendim te Administratorit, Shoqëria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është ALL 100.000 (njëqind mije lekë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Doni Berberi**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme LEKE 32.000 (tridhjetë e dy mije leke) që përben **32% të kapitalit themeltar të shoqërisë.**
2. Ortaku themelues **Illir Dena**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme LEKE 34.000 (tridhjetë e kater mije leke) që përben **34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.**
3. Ortaku themelues **Elton Aliaj**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme LEKE 34.000 (tridhjetë e kater mije leke) që përben **34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.**

Kontributi i ortakëve është në para dhe do të shlyhet prej tyre menjëherë me themelimin e shoqërisë. Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të

E. A. B
JB

J. D.
Med

transferueshme ndërmjet ortakëve. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE
Neni 8
Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.


Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9
Mënyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

E. A. 

J. D. 

10

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.


Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.


Neni 12 Përgjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

E. A. 
43

J. D. 

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë për një mandat 3 (tre) vjeçar emërimi:

- **Z. Doni Berberi**, shtetas shqiptar, i biri i Aranitit, lindur me 30.05.1972 ne Vlore, banues ne Tirane, mbajtës i letërnjoftimit nr. 033506604, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, *pa kufizime ne kompetencat e administrimit.*

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

E. A. B.
SB

J. D.
Djeq

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim a mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme: u kthen ortakëve kontributet; u paguan ortakëve interesa apo dividendë; u shpërndan aktivet shoqërisë; lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Padiësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

E. A. H.

5/3

J. P.
S. P.

Neni 16
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17
Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 18
Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar ne themelimin e saj; me vendim te Asamblese se Ortakeve; me hapjen e procedurave te falimentimit; ne perputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjit 9723/2007; me vendim te gjykatës.



Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë paguese, me perjashtim te rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit qe janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19
Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja



Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 20
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua, nga ortakët themelues si vijon:

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“IDE INVESTMENT” Sh.P.K

Elton Aliaj Mir Dena

Doni BERBERI

Doni B